



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.035/2016

Prishtinë, më 17 qershor 2016,

PROCESVERBAL

Mbledhjen e kryesoi Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit FunkSIONAL.

Në mbledhje morën pjesë: Salihe Mustafa, Nenad Rashiq, Mexhide Mjaku-Topalli, Etem Arifi, Mytahir Haskuka dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Valdete Bajrami dhe Teuta Haxhiu.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Sulltane Gashi, zyrtare e fushës, Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit (UNICEF).

Pjesëmarrës të tjerë: Shefki Kastrati –NDI, Artan Murati-KDI, Ukë Gashi-ZPRK dhe Hajrudin Skenderi- Ambasada e Zvicrës.

Kryetarja i hapi punimet e mbledhjes së Komisionit dhe propozoi që për shkak të punimeve të sotme të seancës plenare, të hiqet pika:- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme.

Anëtarët e Komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e Komisionit FunkSIONAL, ndërsa në vazhdim Komisioni i zhvilloi punimet me këtë rend të ditës:

1. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;

2. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;

Kryetarja tha se me monitorimin e këtij ligji jemi marrë një kohë relativisht të gjatë dhe vlerësoi se është bërë një punë shumë e mirë në këtë drejtim.

Ajo ftoi deputeten Mexhide Mjaku-Topalli, që në emër të grupit punues, ta paraqesë dhe arsyetojë Raportin.

Mexhide Mjaku-Topalli, theksoi se janë ndarë të kënaqur gjatë vizitave të bëra në institucione të ndryshme por edhe me përgjigjet që kanë marrë nga institucionet të cilat i kanë vizituar. Ajo në vazhdim tha se beson se pas miratimit të rekomandimeve nga Kuvendi, ato do të zbatohen dhe në këtë mënyrë do të ketë efekte pozitive në zvogëlimin apo eliminimin e dhunës në familje gjë që është prioritet i ynë kryesor.

Më pas, ajo i paraqiti para Komisionit të gjitha rekomandimet e propozuara dhe ftoi anëtarët e Komisionit që ti analizojnë një nga një.

Nenad Rashiq, lidhur me rekomandimin numër 2, theksoi se do të jetë më e rëndësishme që të parashihet që çdo vit të ketë buxhet të veçantë apo fond emergjent njëvjeçar për strehimoret e Kosovës. Ai ishte i mendimit që të riformulohet rekomandimi numër 2, i cili gjendet në Raport.

Salihe Mustafa, rreth përmbajtjes së rekomandimit nr 2, theksoi se edhe ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, i ka njoftuar se janë duke punuar në këtë drejtim, mirëpo, është e nevojshme që të riformulohet ky rekomandim duke e precizuar që ajo të vlejë vetëm për këtë vit sepse në bazë të deklaratave të ministrit, kjo çështje do të zgjidhet së shpejti.

Mytaher Haskuka, ishte i mendimit që rekomandimi numër 2 dhe 3, të bashkohen sepse pak a shumë e kanë natyrën e njëjtë.

Lirije Kajtazi, lidhur me këtë rekomandim theksoi se nuk është precizuar kompetenca e institucionit që duhet ta bëjë këtë.

Mexhide Mjaku – Topalli, rreth rekomandimit nr. 4 theksoi se është mirë që të bëhet një memorandum bashkëpunimi në mes MAPL-së dhe strehimoreve rreth çështjes së pagesave të punëtorëve sepse në praktikë është hasur si problem.

Nenad Rashiq, duke u ndërlidhur me rekomandimin nr. 4, theksoi se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, deri më tani ka mbështetur vetëm planet operative, por jo edhe pagesat dhe ishte i mendimit se vështirë që do të implementohet ky rekomandim, në mënyrën se si është paraparë.

Ai theksoi se do të ishte mirë që në të ardhmen të mbahen takime dhe vizita, që të kërkohet se çka kanë bërë institucionet lidhur me rekomandimet që kanë dalë nga Komisioni dhe në këtë mënyrë të monitorohet realizimi i tyre.

Mytaher Haskuka, rreth rekomandimit të propozuar nr. 5, propozoi që në fjalinë: Këshilli Gjyqësor i Kosovës të garantojë..., të hiqet fjala “ të garantojë “ dhe në vend të saj të zëvendësohet me fjalën “të caktojë” gjyqtarët e nevojshëm për çështjet dhunës në familje.

Mexhide Mjaku-Topalli, lidhur me rekomandimin nr. 6, theksoi se kanë menduar që të obligohet Koordinatori Nacional me aktorët e tjerë, që ta krijojnë data bazën për rastet e dhunës në familje me qëllim që të ekzistojë numri i saktë i këtyre rasteve.

Mytaher Haskuka, propozoi që në rekomandimin nr.7, të zëvendësohet fjala “ekzistim”, me fjalën” promovim”.

Etem Arifi, përkrahu kërkesën për krijimin e dhomave të veçanta sepse kjo siç tha ai, shkon në dobi të viktimave të dhunës në familje.

Salihe Mustafa, propozoi që përmes një rekomandimi të ri të obligojë institucionet kompetente që të zbatojnë dispozitat ligjore për kompensimin e pagesës së punëtorëve socialë, për punën e bërë jashtë orarit të punës.

Mytaher Haskuka, propozoi që të bëhet një renditje më ndryshe e rekomandimeve dhe të renditen prej të përgjithshmes deri tek ato me specifike.

Lirije Kajtazi, në fund të kësaj pike theksoi se për shkak të ndryshimeve të propozuara të rekomandimeve, në këtë mbledhje, ato të rregullohen nga ana e administratës dhe të pasqyrohen në Raport dhe pastaj ky Raport të miratohet në mbledhjen e radhës së Komisionit.

2. Të ndryshme.

Nenad Rashiq, kërkoi që të analizohet mundësia e çështjes së zgjedhjes së problemit të rastit të zëvendësit të Avokatit të Popullit, Staletoviq.

Lirije Kajtazi, lidhur me këtë çështje theksoi se më 20 qershor 2016, do të bëhet një takim në mes tyre dhe Staletoviqit dhe të mendohet se si të veprohet në vazhdim, pasi që kemi edhe propozimin e Avokatit të Popullit për zëvendësit e tij, dhe të rregullohet kjo gjendje, e cila po vazhdon tash një kohë të gjatë.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 13:50.

Kryetarja e Komisionit

Lirije KAJTAZI

*Procesverbalin e hartoi:
Stafi mbështetës i Komisionit*

